



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 328

Prishtinë, Dt. 06/02/2016

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji / Biologji
Projektpropozimi	"Flora vaskulare në fragmentet pyjore dhe shkurre në rrethinën e qytezës së Malishevës / Vascular flora in forest and shrub fragments in the surroundings of the town of Malisheva"
Kandidati	Mirlinda Mazreku
Mentori	Prof. Dr. Elez Krasniqi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 18.06.2025 Vendimi nr.: 1903

Vlerësimi i dorëshkrimit

Shënimet e përgjithshme

Ky punim i Masterit i kandidates **Mirlinda Mazreku** ka 50 faqe tekst me rrallim normal. Në punim janë paraqitur 18 figura dhe 2 tabela. Ka cituar 30 (burime nga literatura etj.). Punimi ka **abstrakt** dhe **rezyme** në të dy gjuhët (në gjuhën shqipe dhe angleze). Në fund të punimit gjendet **jetëshkrimi**.

Punimi ka në përbërje e tij: **Hyrje** (faqe 13-14), **Qëllimi dhe rëndësia e punimit** (faqe 15), **Të dhëna të përgjithshme për zonën e hulumtuar** (faqe 16-17), **Ndikimi i faktorit antropogjen** (faqe 18), **Flora dhe vegjetacionin në rrethinën e qytezës së Malishevës** (faqe 19-20), **Materiali dhe metodat e**

**hulumtimit** (faqe 21), **Rezultatet** (faqe 22-37), **Diskutim** (faqe 38-39), **Përfundime** (faqe 40), **Literatura** (faqe 42-43), **Rezyme** (faqe 44-46), **Summary** (faqe 47-49). **Jetëshkrim** (faqe 50).

### **Analiza e Punimit**

Në **Hyrje** kandidatja në mënyrë përmbledhëse paraqet të dhëna përgjithshme për zonën e studimit, përfshirë diversitetin bimor (florën dhe vegjetacionin).

Te **“Qëllimi dhe rëndësia e punimit”** arsyetohet qëllimi dhe rëndësia e studimit (hulumtimit).

Në kapitullin **“Të dhëna të përgjithshme për zonën e hulumtuar”**, kandidatja përshkruan të dhëna lidhur me pozitën gjeografike, gjeologjinë, pedologjinë dhe për klimën në zonën e hulumtimit.

**Ndikimi i faktorit antropogjen** shqyrtohet në veçanti.

Në kapitullin **“Flora dhe vegjetacionin në rrethinën e qytezës së Malishevës”** paraqiten të dhëna për florën dhe vegjetacionin e qytezës së Malishevës me rrethinë.

Në pjesë të veçuar në vijim jepen detaje sa i përket **materialit dhe metodave të hulumtimit**.

**Rezultatet e hulumtimit** paraqiten në formë regjistri. Renditja e grupeve të larta bimore është realizuar sipas filogjenisë, përderisa kategoritë më të ulta sistematike (familjet, gjinitë dhe llojet) janë të renditura sipas alfabetit.

Të ilustruara me tabela respektivisht figura paraqiten **"Format korologjike"** dhe **"Format jetësore të bimëve"**.

Në punim janë paraqitur fotografi origjinale në pjesën **"Fotografi të llojeve bimore"**.

Diskutimet dhe përfundimet paraqiten në veçanti bazuar në të gjeturat-rezultatet.

**Literatura** e cituar është e kohës dhe adekuate për hulumtimin dhe analizimin e florës vaskulare.




### Vlerësimi dhe propozimi

Mbështetur në dorëshkrimin e punimit, Komisioni e vlerëson pozitivisht Punimin e masterit me titull **“Flora vaskulare në fragmentet pyjore dhe shkurre në rrethinën e qytezës së Malishevës / Vascular flora in forest and shrub fragments in the surroundings of the town of Malisheva”** të kandidatës **Mirlinda Mazreku**.

Komisioni i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Departamentit të Biologjisë si dhe Këshillit Mësimor-Shkencor të FSHMN-së që ta pranojë propozimin dhe të formoj Komisionin për mbrojtje publike të Punimit të Masterit të lartëpërmendur, me qëllim të arritjes së titullit: Master i Shkencave të Biologjisë (Programi: Biologji).

Prishtinë, 06.02.2026

Komisioni:

1.   
/ Prof. Dr. Fadil Millaku – kryetar/
2.   
/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – anëtar (mentor)/
3.   
/ Prof. Asoc. Dr. Bekim Gashi – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.